DEKRET
Nr.7458, datë 22.1.1991

PËR TË DREJTËN E GREVËS

Neni 1

Greva është ndërprerja e përkohëshme e punës, të cilën punonjësit e përdorin për zgjidhjen e kërkesave të tyre ekonomike e shoqërore dhe që e ushtrojnë në përputhje me rregullat e përcaktuara në dispozitat kushtetuese në këtë dekret.

Pjesëmarrja në grevë është vullnetare. Asnjeri nuk mund të detyrohet që të marrë pjesë në grevë, në kundërshtim me vullnetin e tij.

Ndalohet çdo presion ose formë tjetër detyrimi që pengon shprejen e lirë të vullnetit të punonjësve për të marrë pjesë ose jo në grevë.

Neni 2

Kanë të drejtë të organizojnë e të shpallin grevë, organizatat profesionale ose përfaqësues të autorizuar nga kolektivi punonjës.

Greva mund të shpallet vetëm pasi të kenë votuar për të shumica e punonjësve.

Greva mund të organizohet në shkallë ndërmarrjeje ose njësie më të vogël organizative të saj.

Neni 3

Greva lejohet vetëm për përmirësimin e kushteve të punës e të jetesës, për mbrojtjen në punë, për problemet e shpërblimit të punës, për sigurimet shoqërore, si dhe për të drejta të tjera që lidhen me marrëdhëniet e punës, por kurdoherë mbi bazën e kontratës së punës të lidhur ndërmjet organizatës profesionale dhe punëdhënësit.

Kushtet themelore të kontratës kolektive të punës dhe për grevat rregullohen me ligj.

Neni 4

Organizatorët e grevës duhet të njoftojnë punëdhënësin të paktën 15 ditë përpara, duke përcaktuar kërkesat e grevës, kohëzgjatjen, vendin dhe numrin e pjesëmarrësve në grevë.

Greva e shpallur për herë të parë nuk mund të zgjatë më shumë se një ditë pune. Pas kësaj ajo mund të shpallet, por kurdoherë jo më parë se të kenë kaluar 5 ditë nga shpallja e grevës së parë.

Punonjësit mund të shpallin, pa njoftim paraprak, grevë paralajmëruese, por kjo nuk mund të zgjatë më tepër se një orë.

Neni 5

Ndalohet krijimi i pengesave apo i vështirësive për punonjësit që nuk marrin pjesë në grevë dhe duan të vazhdojnë punën.

Neni 6

Greva nuk lejohet ose kur ka filluar ndërpritet:

a) Në kushtet e luftës ose kur është vendosur gjendja e jashtëzakonëshme;

b) kur në territorin e Republikës së Shqipërisë kanë ndodhur fatkeqësi natyrore;

c) 15 ditë para dhe 7 ditë pas datës së zgjedhjeve në shkallë kombëtare e lokale;

ç) gjatë festave zyrtare, si dhe 2 ditë para dhe pas tyre;

d) në sektorët ku nga ndërprerja e punës rrezikohet jeta dhe shëndeti i njerëzve, si dhe mund të vijnë pasoja të rënda për mbrojtjen e vendit dhe në prodhim;

dh) për zgjidhjen e kërkesave të punonjësve të veçantë;

Greva ndërpritet kur shoqërohet me veprime që përbëjnë vepra penale.

Neni 7

Në sektorët ku punohet për plotësimin e nevojave jetësore të popullit, siç janë furnizimi me bukë, sende konsumi të përditshëm e të domosdoshme, me ujë e energji elektrike e karburante, si dhe të shërbimit komunal e të transportit publik, të shëndetësisë, mbrojtja civile, administrata gjyqësore, postëtelekomunikacioni, radiotelevizioni, arsimi, sigurimet shoqërore, bankave, doganave apo dhe në sektorë të tjerë, ku nga ndërprerja e punës të vijnë pasoja shumë të rënda në dëmtimin e shkatërrimin e impianteve dhe të prodhimeve e proceseve jetësore, grevat lejohen vetëm pasi të jetë siguruar plotësimi i kërkesave më të domosdoshme, por kurdoherë sipas specifikimeve të praktikave në kontratën kolektive të punës.

Neni 8

Greva nuk mund të fillojë pa u bërë të gjitha përpjekjet për zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjeve. Për këtë krijohet komisioni i pajtimit, në të cilin marrin pjesë përfaqësuasit e organizatës profesionale ose të punonjësve dhe përfaqësuesit e administratës së ndërmarrjes. Komisioni i pajtimit ngrihet jo më vonë se pesë ditë nga dita e njoftimit të grevës.

Numri i anëtarëve të komisionit dhe procedura e bisedimeve caktohet në marrëveshje nga palët. Bisedimet nuk mund të zgjasin më tepër se 10 ditë. Me marrëveshje ndërmjet palëve, bisedimet mund të vazhdojnë edhe tej këtij afati.

Rezultatet e bisedimeve shënohen në procesverbalin që nënshkruhen nga palët kur arrihet pajtimi vendimi është i detyrueshëm për t’u zbatuar nga palët.

Neni 9

Kur pajtimi nuk arrihet dhe greva fillon, palët në marrëveshje ndërmjet tyre, kanë të drejtë që t'i drejtohen gjykatës.

Me paraqitjen e kërkesës në gjykatë, greva pezullohet dhe punonjësit fillojnë punën.

Gjykata vendos zgjidhjen e mosmarrëveshjes, duke përcaktuar përgjegjësinë e palëve, veprimet që duhet të kryejnë ato dhe, kur ka pasoja financiare, cakton se kush detyrohet të zhdëmtojë.

Kur përgjegjësia për grevën i takon punëdhënësit, ky detyrohet t'u paguajë punonjësve pagën për kohën e ndërprerjes së punës. Në rast të kundërt punonjësit nuk marrin pagë.

Vendimi i gjykatës është i formës së prerë.

Neni 10

Kur greva është në pajtim me dispozitat e këtij dekreti punëdhënësi gjatë kohës që vazhdon greva nuk lejohet që të marrë punonjës zëvëndësues dhe as të mbyllë ndërmarrjen.

Neni 11

Grevat në kundërshtim me dispozitat e këtij dekreti nuk lejohen. Kur ato kanë filluar,

punëdhënësi merr masa për vazhdimin e punës dhe ndaj punonjësve që nuk rifillojnë punën brenda 3 ditëve ka të drejtë të zgjidhë kontratën e punës dhe të zbatojë, kur është rasti, masa të përgjegjësisë materiale.

Neni 12

Për shkeljen e rregullave të parashikuara në nenet 1 (paragrafi i tretë), 5 dhe 7 të këtij dekreti, organizatorët e grevës apo personat e tjerë fajtorë dënohen me gjobë gjer në 1000 lekë, me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë deri në tre muaj.

Neni 13

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.